

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

12 Maj, 2022

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Rastet pozitive të COVID-19 në Filadelfia janë në rritje. Ekspertët e shëndetësisë kanë thënë se duhet të presim herë pas here rritje të rasteve me COVID-in si një pjesë normale e përparimit të virusit. Në këto raste, ne të gjithë duhet të marrim masa paraprake shtesë për të mbrojtur veten dhe të tjerët rreth nesh. Kjo letër jep një kujtesë të asaj që ne të gjithë mund të bëjmë për të ndihmuar në minimizimin e përhapjes së COVID-19 në shkollat tona dhe shpjegon **“Mask për të qëndruar”** tani në vend për studentët tanë.

- **Maskimi** - në këtë kohë, mbajtja e maskës në shkollat dhe zyrat tona mbetet opsionale, përveç atyre në programet e Pre/K Head Start ku maskimi kërkohet nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore të SHBA-së. Ne inkurajojmë të gjithë që të marrin parasysh me kujdes rrethanat e tyre personale dhe klimën aktuale të COVID-19 kur bëjnë zgjedhjen për mbajtjen e maskës ose jo. Maskat vazhdojnë të jenë të gatshme sipas kërkesës.
- **Vaksinat dhe përforcuesit** - këto mbeten mbrojtja më e mirë nga COVID-19. Nëse ju ose fëmija juaj i kualifikuar nuk e keni marrë ende vaksinën ose vaksinën përforcuese, mund të gjeni vendndodhje pranë jush në faqen e internetit të qytetit të Filadelfias [këtu](#) ose në www.vaccines.gov.
- **E re, Maska të qëndrojnë Opsionale** – Kërkesat që studentët të cilët kanë qenë të ekspozuar ndaj COVID-19 por nuk shfaqin asnjë simptomë të karantinohen në shtëpi ka pasoja jo me qëllim të reduktimit të mësimin në shkollë. Prandaj, Departamenti i Shëndetit Publik të Filadelfias ka këshilluar që ne të ofrojmë në shkolla **“Maska të qëndrojnë”** alternative Pavarësisht nga statusi i tyre i vaksinimit ose statusi i maskimit, studentët që janë në kontakt të ngushtë dhe që janë asimptomatikë mund të qëndrojnë në shkollë nëse:
 - ata mbajnë maskë gjatë ditës së shkollës për 10 ditë pas datës së fundit të ekspozimit, pavarësisht nga statusi i vaksinës,
 - vetë-monitorimi ose monitorimi nga prindërit, për simptomat e COVID-19 dhe
 - izolimi dhe testimi nëse fillojnë të shfaqin simptoma të lidhura me COVID-19.

Studentëve që refuzojnë të mbajnë maskë pasi janë identifikuar në një grup, do t'u kërkohet të karantinohen në shtëpi për 10 ditë ose do të kenë mundësinë të karantinohen në shtëpi, dhe më pas të testohen midis pesë dhe të shtatë ditëve, dhe të kthehen në ditën e tetë në shkollë me një test negativ.

(Albanian)

- **Testimi për COVID-19** - Siç ka ndodhur gjatë gjithë pandemisë, studentët që shfaqin simptoma të COVID-19 duhet të qëndrojnë në shtëpi. Testimi simptomatik do të vazhdojë të jetë i disponueshëm për studentët dhe personelin në këto [pesë vende të Mobile Testing](#) nga e Hëna deri të Premten ,nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 18:00p.m Studentët që shfaqin simptoma të ngjashme me COVID ndërsa janë në shkollë do të testohen nga infermierja e shkollës për aq kohë sa ata kanë një [formular pëlqimi për testimin e COVID](#) (shih seksionin e miratimit të testimit të prindit/kujdestarit për një formular të shkarkueshëm) në dosje. Ju lutemi dorëzojeni këtë formular tek infermierja ose drejtori i shkollës suaj nëse nuk e keni bërë ende këtë.

Individët që rezultojnë pozitivë duhet të izoloohen për 10 ditë dhe të kthehen në ditën e 11 nëse nuk kanë simptoma. Nevoja për testim në të gjitha shkollat do të përcaktohet në bashkëpunim me PDPH dhe Ekipin e Reagimit ndaj COVID të Drejtorise.

Ndërsa hyjmë në javët e fundit të vitit shkollor, le të vazhdojmë të punojmë së bashku për të mbështetur mjedise të shëndetshme të të mësuarit në - person. Ne do të vazhdojmë të punojmë me PDPH për të monitoruar nga afër numërimin e rasteve me COVID dhe për të zbatuar çdo veprim të nevojshëm për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve në shkollat tona.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias